



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 115/ Prot.

Gjirokastër, më 22/09/2020

VENDIM

Nr. 31 datë 22.09.2020

PËR MIRATIMIN E RIORGANIZIMEVE TË NJËSIVE BAZË
DHE TË GRUPEVE MËSIMORE

Në mbështetje të: nenit 25 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 8 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; të udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", pika 8; urdhërit të Rektorit nr. 45, datë 16.09.2020; vendimit të Dekanatit të FESHSH nr. 6 (gjashtë), datë 17.09.2020; vendimit të Dekanatit të FSHN nr. 5 (pesë), datë 18.09.2020; Vendimit të Rektoratit nr. 10, datë 22.09.2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2020,

VENDOSI

Të miratojë strukturimin e njësive bazë dhe të grupeve të mëposhtme si më poshte:

FSHN

1. Njësia Bazë e Biologjisë dhe Kimisë, e përbërë nga 8 (tetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
2. Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, e përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e strukturuar në dy grupe mësimore/shkencore:
 - a. Grupi mësimor/kërkimor i Analizës Matematike, Matematikës së Zbatuar dhe Fizikës.
 - b. Grupi mësimor/kërkimor i Algjebër-Gjeometrisë dhe Informatikës

FESHSH

3. Njësia Bazë e Gjuhëve të Huaja, e përbërë nga e përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e strukturuar në dy grupe mësimore shkencore:
 - a. Grupi mësimor kërkimor i Letërsisë dhe Qytetërimit.



- b. Grupi mësimor kërkimor i Gjuhësisë Teorike dhe Gjuhësisë së Zbatuar
4. Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënjes, e përbërë 9 (nëntë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
5. Njësia Bazë e Historisë dhe Gjeografisë, e përbërë nga e përbërë 9 (nëntë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
6. Të gjitha njësitë e tjara bazë të FSHN, FESHSH, FE, të pa përmendura në pikat 1-5, në të cilat numuri i personelit akademik me kohë të plotë është më pak se 10 (dhjetë), do të vazhdojnë të funksionojnë të pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjherë dhe u përcillet për zbatim administratorit, zëvendës rektorit për procesin mësimor, dekanëve të njësive kryesore, drejtuesve të njësive bazë, kryesekretares mësimore, sektorit të standarteve dhe korrikulave, Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akadematike Administrative, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEHA



VENDOSI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

REKTORATI,

Tel. 00355 84 63408
e-mail: rektori@uogj.edu.al
[http www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

Gjirokastrë, më 07/11/2017

VENDIM


Nr. 13 datë 07. 11. 2017

Bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 pika 5 rektorati në mbledhjen e tij të datës 07. 11. 2017 ;

VENDOSI

1. Të riorganizohen njësitë bazë dhe strukturimi i tyre në grupe mësimore.
2. Të ngrihet një komision ad hoc me nga një përfaqësues të secilit fakultet (të propozuar nga Dekanët) dhe një përfaqësues i Rektoratit, me detyrën për të hartuar kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e përgjegjësive të grupeve mësimore. Komisioni i miratuar ka këtë përbërje:
 1. Prof.asoc Jani Dine
 2. Prof.asoc Abaz Mullai
 3. Prof.asoc Rexhep Shkurti
 4. Dr. Robert Çelo
3. Ky komision, kriteret dhe procedurat e hartuara prej tij të miratohen nga Senati akademik.
4. Përzgjedhja e përgjegjësive të grupeve mësimore të bëhet nga komisionet ad hoc të ngritura nga Dekanët për çdo njësi kryesore, i përbërë nga 3 anëtarë, një prej të cilëve të jetë përfaqësues i Rektoratit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof.dr. Bektash Mema
REKTOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Tel. 00355 84 63408
e-mail: rektori@uogj.edu.al
[http www. uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

Gjirokastrë, më 14 /11/2017

**Kriteret për përzgjedhjen e përgjegjësve të grupeve
mësimore / kërkimore - shkencore**

Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohëshme me karakter kërkimor - shkencor, në përputhje me llojin e misionit të institucionit.

1. Grupi mësimor/kërkimor-shkencor mund të ngrihet mbi bazë moduli, disipline ose moduli të integruar.
2. Numri minimal i pedagogëve për ngritjen e grupit mësimor/kërkimor-shkencor është 3(tre). Departamenti propozon numrin e grupit mësimor/kërkimor-shkencor, të cilët miratohen nga Dekanati, Senati dhe në Bordin e Administrimit.
3. Grupi mësimor/kërkimor-shkencor drejtohet nga përgjegjësi i tij , i cili duhet të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor"
4. Përgjegjësi i grupit mësimor/kërkimor-shkencor përzgjidhet me konkurim të hapur të drejtuar nga një komision ad hoc i ngritur nga Dekani i fakultetit përkatës sipas procedurës së mëposhtme.
 - a. Dekani i fakultetit përkatës shpall datën e zhvillimit të konkursit dhe mbledh Dekanatin për ngritjen e komisionit "ad hoc".
 - b. Komisioni "ad hoc" përbëhet nga 3 anëtarë :
 - Dekani i fakultetit përkatës i cili është dhe kryetar i këtij komisioni,
 - Përgjegjësi i departamentit përkatës
 - Përfaqësuesi i Rektoratit
 - c. Për përgjegjës të grupit mësimor/kërkimor - shkencor ka të drejtë të kandidojë çdo anëtarë i grupit mësimor/kërkimor-shkencor që ka jo më pak se 3 vjet pune në departament me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar.



Nuk kanë të drejtë kandidimi personat që kanë më pak se një vit veprimtari mësimore/ kërkimore - shkencore para daljes në pension. Secili kandidat i drejton një kërkesë Dekanit dhe dorëzon një dosje, e cila përmban curriculum vitae dhe dokumentacionin mbi aktivitetin shkencor brenda dhe jashtë vendit, projekte e studime të kryera. Çdo aktivitet i mësipërm duhet të jetë i bashkëlidhur dhe i dokumentuar dhe i vërtetuar.

- Në datën e caktuar komisioni ad hoc mblidhet dhe bën renditjen e kandidatëve për përgjegjësa të grupeve mësimore/kërkimore-shkencore sipas plotësimit të kriterëve me pikë. Skema e vlerësimit hartohet dhe miratohet me vendim të Komisionit ad hoc përpara mbarimit të afatit të fundit për regjistrimin e kandidaturave. Në rast se nuk vendoset ndryshe përdoret skema bashkëngjitur.
 - Si rregull, komisioni për zgjedh kandidatin me titullin/gradën më të lartë shkencore.
 - Në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë të njëjtin titull akademik, atëherë renditja bëhet duke i vlerësuar me pikë veprimtarinë mësimore/kërkimore-shkencore të secilit kandidat.
- d. Përgjegjësi i departamentit i propozon Dekanit të fakultetit përkatës emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni "ad hoc" për një periudhë 4-vjeçare.

Komisioni ad hoc

1. Prof.asoc Jani Dine përfaqësues i rektoratit
2. Prof.asoc Abaz Mullai përfaqësuesi i FESHSH
3. Prof.asoc Rexhep Shkurta përfaqësues i FSHN
4. Dr. Robert Çelo përfaqësues i FE



**TË DHËNA PERMBLEDHESE PËR AKTIVITETIN KERKIMOR-
SHKENCOR TË PERSONELIT AKADEMIK
TE DEPARTAMENTIT _____
PEDAGOGU _____**

Nr.	Emertimi i zerave	Nen/zerat	Sasia ne n/zera	Sasia ne total	Verejtje
1.	Artikuj shkencore 200-250 ore = 8-10 pike	Brenda vendit Jashte Me Faktor Impakti Vendit Pa faktor Impakti			
2.	Referime ne Konferenca shkencore 100-150 ore, =4-6 pike	Kombetare Nderkombetare			
3.	Referime ne Konferenca te botuara ne Proceedings 100-150 ore, =4-6 pike	Kombetare Nderkombetare			
4.	Tekste universitare 500 ore=20 pike				
5.	Tekste parauniversitare 250 ore =10pike				
6.	Tekst-maket universitar 250 ore =10pike				
7.	Cikle leksionesh 250 ore =10pike				
8.	Monografi 1000ore=40pike				
9.	Udheheqje shkencore	Doktorature 90 ore=3.6 pike Master Shkencor/Profesional 130 ore=1.2pike Diplome Bachelor 30 ore=1.2 pike			
10.	Oponence, 5-10 ore=0.4 pike	Tekste & Diploma			
11.	Pjesmarrje ne aktivite shkencore (pa referim) 5-10 ore=0.4 pike	Konferenca Workshope Seminare etj.			
12.	Plane mesimore	Hartime te reja Permiresime			
13.	Programe mesimore	Hartime te reja Permiresime			
14.	Artikuj shkencore ne publicistike 5-10 ore=0.4 pike	Ne revista e gazeta shkencore			
15.	Pjesmarrje ne projekte 25 ore=1 pike				
16.	Analiza shkencore (review) , 25 ore=1pike				
17.	Pjesmarrje ne borde editorial periodikesh 25 ore=1pike	Brenda vendit Jashte vendit			
18.	Recensa shkencore per artikuj shkencore 5-10 ore=0.4 pike	Brenda vendit Jashte vendit			
19.	Studime Postdoktorale 50 ore=2 pike	Jashte vendit			
20.	Tituj dhe grada te fituara ose ne proces	Profesor Prof.asoc. Dr. Docent Master			

25 ore =1 pike

